



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA HANI ELEZIT  
MUNICIP. OF HANI ELEZIT

---

**DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA  
DEPARTMENT OF FINANCE AND BUDGET**

Nr. 04 / \_\_\_\_ /2011

**DRAFT KORNIZA AFATMESME BUXHETORE  
E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT 2012-2014**

HANI I ELEZIT, Qershor 2011

---

## **I. SHQYRTIMET HYRËSE**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa (DBF-ja), në zhvillimin e aktiviteteve rreth përgatitjes dhe hartimit të Draft - Buxhetit afatmesëm të komunës për periudhën e viteve 2012-2014, ka aplikuar procedurat më të avancuara – reformuese, siç janë rekomanduara nga MF-ja dhe në mbështetje të plotë me dispozitat e Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal ( LFPL), Ligjit mbi Menaxhimin Financave Publike dhe Përgjegjësit (LMFP), Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve ( KASH-it ), si dhe të Qarkoreve Buxhetore të MF-së për Komunitat nr. 2012/01.

Me procesin buxhetor 2012-2014, është filluar nga hartimi Qarkores së Brendshme Buxhetore Komunitare nr. 2012/01 dhe me përgatitjen e Draft - Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunitare - KABK për vitet 2012-2014, të cilat dokumente do të jenë bazë për të gjitha programet buxhetore ( 10 - sish), që të iniciojnë dhe zhvillojnë të gjitha aktivitetet vijuese deri te faza e fundit, kur dhe do të bëjmë edhe hartimin e draftit final të buxhetit të komunës për periudhën afatmesëm 2012-2014, me miratimin e tij në Kuvend të Komunës, jo më larg se deri më 30 shtator 2011.

Instrukcionet dhe rekomandimet e marrura nga niveli qendror, e në veçanti duke u mbështetur në projeksionet në nivel të vendit të prezantuara në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve ( KASH) për vitet 2012-2014, në kufijtë fillestarë të financimit nga granti qeveritar të marrura nga Komisioni i Granteve, etj., obligohemi edhe ne si komunë, të hartojmë Draft - Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës ( shkurtimisht KABK-ja ), i cili për të ardhmen tonë, paraqet një dokument qenësor për proceset e më tejme të zhvillimit të buxhetit komunal, mbi të gjitha, do të na shërben dhe do të na ndihmon si, dokumentacion ndërlidhës i potencialeve në dispozicion, me synimet dhe prioritetet e komunës për tri vitet e ardhshme buxhetore 2012-2014.

Po ashtu, vlen të përmendet se mbështetur në të dhënat e pasqyruara sipas vlerësimeve të hershme indikative, të bazuar në kufijtë fillestar të marrura nga Komisioni Qendror i Granteve, KABK-ja në brendi të saj na ofron gjithashtu politikat dhe objektivat zhvillimore për periudhën e tri viteve vijuese, mënyrat dhe format e përmbysjes së këtyre politikave, burimet e mjeteve financiare etj, si dhe sfidat dhe rreziqet eventuale gjatë zbatimit të këtyre politikave për vitet buxhetore 2012-2014.

Korniza afatmesme buxhetore ( KAB ) komunitare paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunitare gjatë periudhës së ardhshme tre vjeçare.

Me KAB – Komunitare do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioritetëve të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Hanit të Elezit si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2012 – 2014.

Me Qarkoren Buxhetore të parë 2012/01 dhe ku për Komunën tonë paraqiten udhëzimet e para, kalendari kohor ,kufijtë e granteve qeveritare të financimit për përgatitjen e Buxhetit Komunal për vitet 2012 - 2014 .

Financimi komunal agregat për vitet 2012-2014 do të jetë nga :

Tabela -1.

Nr	Transferet Qeveritare	2012	2013	2014
1.	Granti i përgjithshëm	641,402	662,250	675,557
2.	Granti specifik i Arsimit	613,304	613,304	613,304
3.	Granti specifik i Shëndetësisë	182,021	182,021	182,021
4.	Të hyrat vetanake	153,000	159,000	163,300
	<b>Totali</b>	<b>1,589,727</b>	<b>1,616,575</b>	<b>1,634,182</b>

## 2.Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale

Me projeksionet e dhëna vlerësuese për vitet 2012-2014, të hyrat e gjithmbarshme buxhetore komunale, parashikohen të jenë në vitin 2012 në shumë prej **153,000 €**, në vitin 2013 prej **159,000 €** dhe në vitin 2014, në shumë prej **163,300 €**.

Sipas këtyre të dhënave indikative, buxheti i komunës për tri vitet e ardhshme ka trende rritëse. Buxheti i vlerësuar për vitin 2012, është në shumë totale prej **1,589,727 €** ( sipas strukturës burimore: nga granti qeveritar **1,436,727 €** dhe nga të Hyrat Vetanake në shumën prej **153,000 €** )

Analizuar në vlerësimet e hershme buxhetore për periudhën afatmesme 2012-2014, buxheti i projektuar në vitin 2012, është (1,589.727) kundrejt me atë të vitit 2013,(1,616,575) paraqet një rritje prej 4.02 %, kurse buxheti i vlerësuar për vitin 2014, është (1,634,182), në raport ndaj vitit 2012, parashikohet të ketë një rritje prej 7.34%, kurse ndaj vitit 2013, një rritje vetëm prej afër 3.46% .

Sipas këtyre projeksioneve fillestare, mund të konstatohet se, trendet buxhetore për vitet 2012-2014, prej vitit në vit parashikohet që të shënojnë rrjedha të rritjes së matur ( të përmbajtur ), pikërisht nga fakti se ende nuk kemi ndonjë politikë fiskale favorizuese nga niveli qendror dhe as që kemi arritur deri më tani në një zhvillim dhe ekonomi të qëndrueshme, si në nivelin komunal, ashtu edhe në atë të vendit.

Bazuar në kufijtë fillestar nga Komisioni i Granteve të publikuara në Qarkoren e brendshme buxhetore të MF-së 2012/01- për Komunat, financimi qeveritar për vitet 2012-2014, gati do të ketë strukturë të njëjtë dhe pa ndryshime strukturale ( 90.38% deri në 9.62,% ) në favor të grantit, vërejmë se edhe në tri vitet vijuese nuk do të kemi ndryshime të mëdha të këtyre raporteve, sespse me politikën aktuale fiskale dhe projeksioneve vijuese, të hyrat vetjake komunale do të ndryshojnë një pjesëmarrje te

vogël strukturale në krijimin e buxhetit të komunës. Granti qeveritar apo ai nga Fondi i posaçëm i Buxhetit të Komunave në nivel të Buxhetit të Konsoliduar të Republikës së

Kosovës ( BKRK-së), në praninë e kësaj politike fiskale të centralizuar, me ndryshimet e reja ligjore, e sidomos me miratimin e Ligjit për Financat Lokale, përpos disa ndryshimeve në format dhe kriteret e ndarjeve buxhetore, nuk kemi të bëjmë me ndonjë mbështetje më të madhe financiare, e sidomos këtu mendohet për komunat e vogla të cilat janë të evidentuar me më pak se 50,000 banorë.

Shikuar sipas viteve dhe strukturës së burimeve të mjeteve, në vazhdim prezantojmë këtë pasqyrë tabelare:

**Tabela -2**

	Realizimi	Buxheti i Aprovuar	Planifikimi	Vlerësimet e hershme		Struktura në përqindje - %				
				2010	2011	2012	2013	2014	2010	2011
<b>Totali (1+2)</b>	<b>1,375,109</b>	<b>1,537,638</b>	<b>1,589,727</b>	<b>1,616,575</b>	<b>1,634,182</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>
1. Granti qeveritar	1,159,757	1,405,656	1,436,727	1,457,575	1,470,882	84.34	91.42	90.38	90.16	90.01
2. HVK-të	215,352	131,982	153,000	159,000	163,300	15.66	8.58	9.62	9.84	9.99
*Tarifat & ngark.	146,580	80,982	98,600	103,500	107,800	68.07	61.36	65.10	65.09	64.79
*Tatimi ne prone	54,229	40,000	42,000	43,000	45,000	25.18	30.31	27.45	27.04	27.56
*Gjobat e trafikut,	14,544	11,000	11,400	12,500	12,500	6.75	8.33	7.45	7.86	7.65

Nga të dhënat e sipërshënuara në Tabelën - 2, vërehet se të hyrat vetjake komunale (shkurtesa - HVK-të) për vitin 2011, janë planifikuar në shumë prej 131,982 €, ndërsa për vitin vijues afatmesëm 2012-2014, përkatësisht në vitin 2012, parashikohen HVK-të në shumë prej 153,000 € , pastaj në vitin 2013 në shumë prej 159,000 € dhe në vitin 2014 në shumë prej 163,300 € të cilat do të krijohen nga të hyrat direkte ( tarifat dhe ngarkesat e ndryshme sipas rregulloreve dhe vendimeve të miratuara komunale dhe nga të hyrat e Tatimit në Pronë) dhe ato indirekte, kryesisht vetëm nga gjobat e trafikut, të cilat do të kenë destinim, kryesisht vetëm për realizimin e projekteve të infrastrukturës komunale.

Duhet theksuar, se te të hyrat indirekte, te donacionet dhe te participimet e komunitetit për realizimin e projekteve të interesit të përbashkët publik, kemi qenë të përmbajtur në dhënien e vlerësimeve, për shkak se tani për tani jemi në mangësi me të dhënat në formë të shkruar, d.m.th, kemi nga ata zotim apo firmosje të ndonjë kontrate apo marrëveshje. Sido që të jetë, në fazat vijuese, te kjo kategori e të hyrave do të ketë

ndryshime pozitive nga aspekti i inkorporimit të tyre në realizimin e projekteve të përbashkëta të infrastrukturës komunale.

Bazuar në vlerësimet e hershme të grumbullimit të parashikuar të HVK-ve për vitet 2012-2014, si dhe trendeve të realizuar në dy vitet e fundit 2009-2010, të hyrat nga Taksat dhe ngarkesat komunale do të kenë rolin dominant dhe do të paraqesin gjeneratorin kryesor në krijimin e të hyrave vetjake komunale (HVK-të).

Nga e gjithë kjo që u elaboruar më lartë, lirisht mund të konstatojmë se përmbushja e të hyrave të përgjithshme buxhetore komunale, përveç varshmërisë së mëtejme që do të kemi nga grantet qeveritare (90%), kuptohet gjithsesi, se do të jemi të varur edhe nga dinamika e realizimit të të hyrave direkte komunale, të cilat në vitin 2012, vlerësohen të jenë në shumë prej 153,000€, që paraqet mundësitë reale të komunës për përmbushjen e këtij objekti.

Nëse, do të veçonim ndonjë burim nga të hyrat komunale direkte, atëherë do të dalloheshin të hyrat nga Taksat dhe Ngarkesat Komunale dhe Tatimin në Pronë si të hyrat më të qëndrueshme në krijimin e buxhetit komunal, me vjeljen e së cilës kemi filluar që nga viti 2007 dhe është karakteristike të potencohet, se kjo taksë komunale prej vitit në vit po shënon trende të rritjes së vazhdueshme dhe parashikohet që në kontinuitet, e sidomos në periudhën afatmesme buxhetore 2012-2014, të jetë gjithsesi, si burime kryesore në krijimin e të hyrave komunale buxhetore dominim të të hyrave nga taksat komunale në nivel komunal.

Për të pasur një pasqyrë sa më të mirë të të gjitha të hyrave komunale të cilat aktualisht vjeljen sipas akteve komunale dhe rregullativës së lejueshme ligjore, në tabelën – 3, në mënyrë të detajzuar ofrojmë tabelarin e vlerësimeve të hershme të të hyrave vetjake për tri vitet vijuese afatmesëm 2012-2014 me mundësinë e aplikimit të disa kategorive të reja në grumbullimi e tyre në kompetencë komunale, e sidomos të taksave vjetore në regjistrimin e automjeteve që kemi filluar nga fillimi i vitit 2008.etj., si dhe angazhimi i drejtorive përkatëse në realizimin e parashikimeve për gjetjen e donacioneve të brendshme nga niveli qendror, duke mos anashkaluar edhe respektimin obligativ të rregullave në bashkëfinancim me komunitetin.

Tabela 3. Planifikimi i të Hyrave Vetanake Komunale për vitet 2012-2014

Planifikimi i të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2012 - 2014

		Formulari THV - 2012	Formulari THV - 2013	Formulari THV - 2014
Komuna e Mitrovicës		në Euro	në Euro	në Euro
Nr.rendor	Burimet e të Ardhurave	Totali	Totali	Totali
<b>I-A.</b>	<b>TË ARDHURAT E ADMINISTRATËS KOMUNALE - Direkte</b>			
<b>1</b>	<b>Licencat komerciale dhe të biznesit / Lejet</b>	<b>67,400</b>	<b>68,800</b>	<b>69,200</b>
1.1.	Funksionimet e dyqaneve të mëdha dhe shërbimeve tjera	5,000	6,000	6,200
1.2.	Funksionimet e aktiviteteve industriale ose aktiviteteve të lidhura me ndërtimin	50,000	50,000	50,000
1.3.	Funksionimi me shitore në rrugë ose afër rrugëve, kioske, karroca të vogla lëvizëse	2,400	2,800	3,000
1.4.	Funksionimet e bankave, kompani .të sigurimit dhe shërbimeve tjera financiare	6,000	6,000	6,000
1.5.	Funksionimet e Gurëthyesve, minierave	4,000	4,000	4,000
<b>2</b>	<b>Liçensat për lojra zbavitëse, pije alkoolike, reklamime, shpallje etj. / Lejet</b>	<b>2,500</b>	<b>2,500</b>	<b>2,500</b>
2.1.	Funksionimet me makina me monedha ose me lojëra dh të ngjashme	-	-	-
2.2.	Funksionimet dhe vendosja e shërbimit të pijeve alkoolike	-	-	-
2.3.	Reklamimi, publikimi në pronën Komunale	2,500	2,500	2,500
<b>3</b>	<b>Liçensat profesionale / Lejet</b>	<b>900</b>	<b>1,000</b>	<b>1,000</b>
3.1.	Funksionimi i shërbimeve profesionale (.Avokatët, Mjekët, Dendistet, etj.)	900	1,000	1,000
<b>4</b>	<b>Shfrytëzimi i Tokës dhe Lejet e ndërtimit</b>	<b>7,000</b>	<b>7,300</b>	<b>7,300</b>
4.1.	Lejet për ndërtim dhe konstruktive	5,000	5,500	5,500
4.2.	Pagesat e ndërrimit të destinimit të tokës ekzistuese	1,000	1,000	1,000
4.3.	Pagesat e demolimit	1,000	800	800

4.4.	Pagesat me ndikim nga shfrytëzimi i madh i rrugëve publike apo i shërbimeve publike të siguruar për ndërtim ose operim komercial duke përfshirë edhe vendet e nxjerrjes së resurseve natyrore.	-	-	-
4.5.	Tatimet nga nxjerrja e Resurseve natyrore (Neni 10.5 CFA Udhëzim Ad...Nr.2001/03 dhe 2001/02 DLA)	-	-	-
<b>5</b>	<b>Inspektimi i tokës dhe aktivitetet Gjeodezike</b>	<b>600</b>	<b>600</b>	<b>600</b>
5.1.	Përgatitja e plan. urban dhe inspekt. që kanë të bëjë me dimensionet e pronës	-	-	-
5.2.	Aktivitetet në terren që kanë të bëjë me matjen e vendit	600	600	600
<b>6</b>	<b>Shërbimet e inspektimit të Shëndetit dhe Sigurisë</b>			
6.1.	Inspektimi i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim publik			
6.2.	Inspektimi i ambientit			
6.3.	Inspektimi i ndërtimit, shërbimit të zjarrfikësve dhe konstruktimit			
<b>7</b>	<b>Shfrytëzimi i pronës Komunale</b>	<b>4,000</b>	<b>4,000</b>	<b>4,000</b>
7.1.	Baza ditore, bazat tjera për shfrytëzimin e pronës publike për aktivitetet komerciale - jo komerciale			
7.2.	Ngarkesat për hapsirë në tregje ose në objekte të ngjajshme			
7.3.	Marrja me qira e objekteve komunale për një afat të gjatë	4,000	4,000	4,000
7.4.	Të hyrat nga shitja e pronës komunale			
<b>8</b>	<b>Pagesat në lidhje me Automjetet</b>	<b>20,150</b>	<b>22,250</b>	<b>22,300</b>
8.1.	Lejet e automjeteve	750	750	750
8.2.	Parkimi në parkingun publik i paisur me garazhim apo hapsira tjera			
8.3.	Gjobat në trafik	11,400	12,500	12,500
8.4.	Largimi dhe deponimi i automjeteve			
8.5.	Regjistrimi i automjeteve	8,000	8,000	8,000
<b>9</b>	<b>Çertifikatat dhe Dokumentet Zyrtare</b>	<b>5,250</b>	<b>5,940</b>	<b>6,550</b>

9.1.	Pagesat e regjistrimit të pronës dhe të transferit	50	100	100
9.2.	Dokum.lidhur me statusin shoqëror si dhe të lindjes,vdekj,martesës,shkurorizimit	3,200	3,500	3,600
9.3.	Pagesat për kopjet shtesë të çertifikatave/dokumenteve	300	600	850
9.4.	Taksa administrative	1,500	1,500	1,700
9.5.	Të tjera	200	240	300
<b>10</b>	<b>Taksa e pronës</b>	<b>42,000</b>	<b>43,000</b>	<b>45,000</b>
10.1.	Pagesat e taksës së pronës	42,000	43,000	45,000
<b>11</b>	<b>Të ardhurat tjera</b>	<b>11,275</b>	<b>11,557</b>	<b>11,846</b>
11.1.	Përfitimi nga privatizimi	-	-	-
11.2.	Regjistrimi i Biznesit -			
11.3.	Të hyrat nga kontestet e komunes	-	-	-
11.4.	Gjobat tjera	-	-	-
11.5.	Pagesat tjera	-	-	-
<b>I - A.</b>	<b>Nëntotali I-A , Të ardhurat direkte (Tarifat dhe ngarkesat)</b>	<b>149,800</b>	<b>155,690</b>	<b>1,59,850</b>
1.1.	Denimet në komunikacion,të grumbulluara përmes Nivelit Qendror (ShPK)			
1.2.	Të tjera	-	-	-
1.3.		-	-	-
1.4.		-	-	-
<b>I - B.</b>	<b>Nëntotali I-B , Të ardhurat indirekte (Pjesa që i takon komunave)</b>			
<b>I</b>	<b>Totali I Administrates komunale (Direkte dhe Indirekte &amp; IA+IB )</b>	<b>149,800</b>	<b>155,690</b>	<b>159,850</b>
	<b>TË ARDHURAT NGA ARSIMI</b>			
1	Qerdhet			

2	Arsimi parashkollor			
3	Arsimi fillor			
4	Arsimi i mesëm			
5	Mësimi joformal			
6	Të tjera			
<b>II</b>	<b>Totali - Arsimi</b>			
	<b>Të ARDHURAT NGA SHËNDETËSIA</b>			
1	Shëndetësia primare	3,000	3,100	3,200
2	Të tjera ( Nga të Hyrat Vetanake Komunale )	200	210	250
<b>III.</b>	<b>Totali - Shëndetësia</b>	<b>3,200</b>	<b>3,310</b>	<b>3,450</b>
<b>Kodi 21</b>	<b>TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNES ( I+II+III ):</b>	<b>153,000</b>	<b>159,000</b>	<b>163,300</b>
<b>IV.</b>	<b>Donatorët e mbrendshem ( IV )</b>			
1.1	Participimi I popullates			
1.2	Grantet e donatorve te mbrendshëm ( ministritë apo të tjerë )			
1.3	Të hyrat dhe donacionet tjera			
1.4	Tjera			
<b>Kodi 31</b>	<b>Total ( IV )</b>			
<b>V</b>	<b>Donatorët e Jashtëm ( V )</b>			
	<b>Gjithsej të ardhurat e komunës ( I+II+III+IV )</b>	<b>153,000</b>	<b>159,000</b>	<b>163,300</b>

Ne vazhdim në tabelën -4, pasqyrojmë realizimin e të hyrave buxhetore nga burimet vetanake sipas programeve buxhetore me vlerësimet e hershme për vitet 2012-2014, siç vijon më poshtë:

**Pasqyra e të hyrave vetanake komunale dhe struktura sipas programeve buxhetore**

**Tabela – 4**

Nr	Përshkrimi	Realizimi 2010	Buxheti 2011	Planifikimi 2012	Vlerësimi 2013	Vlerësimi 2014
1	2	3	4	5	6	7
1	Administrata	11,357.50	5,000	5,250	5,940	6,550
2	Buxhet dhe Financa	160,496.84	111,250	130,450	135,050	137,500
3	Planifikim Urban dhe Mjedis	25,756.64	12,482	14,100	14,700	15,800
4	Shëndetësi dhe MS	3,197.60	3,000	3,200	3,310	3,450
	Totali – (1 deri 4):	200,808.13	131,982	153,000	159,000	163,300

**Pasqyra e të hyrave vetanake komunale dhe struktura sipas programeve buxhetore në përqindje (%)**

**Tabela – 5**

Nr	Përshkrimi	Realizimi 2010	Buxheti 2011	Planifikimi 2012	Vlerësimi 2013	Vlerësimi 2014
1	2	3	4	5	6	7
1	Administrata	5.66	3.79	3.43	3.74	4.01
2	Buxhet dhe Financa	79.93	84.48	85.26	84.94	84.20
3	Planifikim Urban dhe Mjedis	12.83	9.46	9.22	9.25	9.68
4	Shëndetësi dhe MS	1.58	2.27	2.09	2.08	2.11
	Totali – (1 deri 4):	100	100	100	100	100

### **III. KORNIZA E SHPENZIMEVE BUXHETORE**

#### **1. Vlerësimet e hershme të programeve buxhetore**

Zhvillimi me kohë i aktiviteteve dhe zbatimi i të gjitha fazave rreth përgatitjes dhe hartimit të draft-buxhetit të komunës, deri në fazën e miratimit në Kuvend të Komunës, paraqet një proces shumë të rëndësishëm dhe transparent, si nga aspekti i planifikimit të mirëfilltë, ashtu edhe në segmentin e realizimit të shpenzimeve buxhetore në mënyrë adekuate dhe në përputhje me politikat dhe objektivat e parashikuara të zhvillimit të komunës.

Vlerësimet e hershme janë veçmas të domosdoshme për shqyrtimin e duhur të shpenzimeve operative dhe të konsumit investiv.

Në përcaktimin e projeksioneve të hershme të shpenzimeve buxhetore për vitet 2012-2014 sipas kategorive kryesore ekonomike, jemi bazuar kryesisht në operimin e realizuar buxhetor në vitin 2010\*, në objektivat e miratuara me buxhetin e vitit 2011, si dhe në realizimin e mjeteve buxhetor për pesëmuajorin e parë të vitit aktual 2011.

#### **1.1. Pagat dhe Mëditjet**

Përgjithësisht, në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve, në krahasim me buxhetin e vitit 2010, paraqiten kërkesa të reja për rritjen e numrit të të punësuarve mirëpo një gjë e tillë me qarkoren buxhetore 2012/01 për komuna të MF-ja dhe presime qarkoren e dyte të caktohen kufijtë e kategorive ekonomike dhe të stafit..

Në vazhdimësi, kemi kërkesa dhe jepen instruksionet nga Qeveria Qendrore dhe MF-ja, që të gjitha organizatat dhe agjensionet buxhetore, duhet në kontinuitet gjithsesi t'i rishqyrtojnë dhe të bëjnë studime të detajizuara rregulloreve mbi sistematizimin e vendeve të punës (rishikimi i organogrameve funksionale).

Mbetet detyrë permanente, që edhe për vitet 2012-2014, në përbërje të organizatës buxhetore të komunës, me bartësit e programeve buxhetore (drejtorët), të kategoria e shpenzimeve për Paga dhe Mëditje, të kemi një qasje më të mirëfilltë, duke bërë:

- ⇒ Rishqyrtimin e politikave të reja me një analizë dhe studim të hollësishëm në rritjen e pjesëmarrjes së shpenzimeve të Pagat dhe Mëditjet nga 61.93%, sa është me buxhet të vitit 2011 , në 65.08% për vitet tjera në vazhdim deri me 2014.

### **Sfidat kryesore politike :**

- ristrukturimi i mëtejshëm i programeve buxhetore në nivel të Organizatës Buxhetore të komunës, ashtu siç parashikohet me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale;
- shpenzimet për Paga dhe Mëditje janë parashikuar të rriten vetëm sa për të mbuluar rritjen potenciale të rrogave të mësimdhënësve me 50% , ndërsa për punëtorët e shëndetësisë një rritje prej 30% dhe për shërbyesit civil është planifikuar një rritje prej 30% .

### **Mallrat dhe Shërbimet**

Kjo kategori e shpenzimeve, sipas vlerësimeve tona të hershme të prezantuara në tabelat 6, dhe 7, nuk do të ketë ndryshime strukturale në të dalurat e përgjithshme buxhetore, të cilat janë në raport me buxhetin aktual të vitit 2011.

Rekomandohet që në periudhën e tri viteve 2012-2014, në të gjitha programet buxhetore në nivel të organizatës buxhetore të komunës, që të:

- rishikohen të gjitha mundësitë në reduktimit të këtyre shpenzimeve duke aplikuar kursimet të të gjitha llojet e shpenzimeve operative dhe nivelet;
- të krijohen të gjitha parakushtet që mbulimi i këtyre shpenzimeve kryesisht të financohen nga Grant i Qeverisë, pa një participim nga të hyrat vetjake komunale - HVK-të;
- racionaliteti dhe realizimi i shpenzimeve në suaza të mjeteve në dispozicion me një përgjegjësi më të lartë personale dhe kolektive, aprovimi dhe marrja e vendimeve për këto lloje të shpenzimeve konform linjave të miratuara buxhetore;

### **1.3. Subvencionet dhe Transferet**

Me projeksionet e vlerësuara 2012-2014, parashikohet një rritje nominale në strukturën e përgjithshme të shpenzimeve buxhetore ( me buxhet të vitit 2012, kjo kategori e shpenzimeve merr pjesë me 1.88 %, në krahasim me 2011 sa kemi marr pjesë me 0.54%, ndërsa planifikohet që një pjesë e subvencioneve të jepet për ( bursa për student , pagesa për familje të dëshmorëve, subvencione për fermerët etj).

### **1.4. Shpenzimet Kapitale**

Në këtë periudhë afatmesme të Investimeve Publike nuk do t'i jepet tretmani i merituar nga aspekti i shpërndarjes së mjeteve buxhetore dhe se me projeksionet e dhëna me KAB-Komunale 2012-2014, nuk kemi rritje të konsiderueshme të mjeteve investive në krahasim me vitet paraprake, sepse , nga niveli qendror nuk kemi rritjen e grantit qeveritar të Shpenzimet Kapitale ( me buxhet 2011 shpenzimet për investime kapitale shënojnë pjesëmarrje me **25.80 %**, kurse për vitin 2012 vlerësohet një zvogëlim prej **21,78%**, në vitin 2013 do të kemi një rritje me **23.04%** dhe në vitin 2014 me **23.61%**),

Tabela - 6

## Buxheti Aktual per vitin 2011

		<b>Shpenzimet per vitin 2011</b>										
	<b>Programet Buxhetore</b>	Nr I Stafit	Paga	Mallra dhe sherbime	Shpenzimet Komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	<b>Gjithsej</b>	Granti i pergjith.	Grant i A. & Shend.	HVK 2011	<b>Totali i Buxhetit</b>
1	<b>Zyra e Kryetarit</b>	6	34,196	22,000	-	8,251	-	64,447	64,447			64,447
2	<b>Zyra e Kuvendit</b>		43,987	1,495	-	-	-	45,482	45,482			45,482
3	<b>Administrata</b>	17	57,134	45,000	14,528	-	-	116,662	116,662			116,662
4	<b>Buxhet &amp; Financa</b>	8	34,227	3,550	-	-	-	37,777	37,777			37,777
5	<b>Sherbime Publike</b>	8	35,078	12,071	-	-	-	47,149	47,149			47,149
6	<b>Zyra per Komunitete</b>	1	3,012	-	-	-	-	3,012	3,012			3,012
7	<b>Bujqësi, Pylltari</b>	3	11,534	2,100	-	-	-	13,634	13,634			13,634
8	<b>Zhvillim ekonomik</b>	2	8,264	1,500	-	-	-	9,764	9,764			9,764
9	<b>Planifikim Urban</b>	7	30,596	5,225	-	-	252,754	288,575	288,575		131,982	420,557
10	<b>Shëndetësi</b>	32	139,171	18,000	6,000	-	-	163,171	-	163,171		163,171
11	<b>Sherbimet sociale</b>	2	8,613	7,000	-	-	-	15,613	7,000	8,613		15,613
12	<b>Arsim &amp; Shkence</b>	125	546,515	32,755	9,000	-	12,100	600,370		600,370		600,370
	<b>Totali</b>	<b>211</b>	<b>952,327</b>	<b>150,696</b>	<b>29,528</b>	<b>8,251</b>	<b>264,854</b>	<b>1,405,656</b>	<b>633,502</b>	<b>772,154</b>	<b>131,982</b>	<b>1,537,638</b>

Tabela - 7

Planifikimi i Buxhetit për vitin 2012

Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2012												
Nr	Programet buxhetore	Nr i Stafit	Paga	Mallra dhe sherbime	Shpenzimet Komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Gjithsej	Granti i pergjith.	Grant i A. & Shend.	HVK 2011	Totali i Buxhetit
1	Zyra e Kryetarit	7	45,300	22,000	-	25,000	-	92,300	92,300	-	-	92,300
2	Zyra e Kuvendit		50,000	1,500	-	-	-	51,500	51,500	-	-	51,500
3	Administrata	15	60,790	45,000	17,000	-	-	122,790	122,790	-	-	122,790
4	Buxhet dhe Financa	7	35,750	3,700	-	-	-	39,450	39,450	-	-	39,450
5	Sherbime Publike	8	40,290	12,210	-	-	-	52,500	52,500	-	-	52,500
6	Zyra për Komunitete	1	3,892	-	-	-	-	3,892	3,892	-	-	3,892
7	Bujqësi, Pylltari	4	17,120	2,500	-	5,000	-	24,620	24,620	-	-	24,620
8	Zhvillim Ekonomik	2	11,102	1,500	-	-	-	12,602	12,602	-	-	12,602
9	Planifikim Urban	7	34,920	5,000	-	-	181,657	221,577	221,577	-	153,000	374,577
10	Shëndetësi	32	159,000	17,021	6,000	-	-	182,021	-	182,021	-	182,021
11	Shërbimet sociale	3	13,171	7,000	-	-	-	20,171	20,171	-	-	20,171
12	Arsim dhe Shkencë	126	565,831	30,000	9,000	-	8,473	613,304	-	613,304	-	613,304
		212	1,037,166	147,431	32,000	30,000	190,130	1,436,727	641,402	795,325	153,000	1,589,727

Tabela - 8

*Krahasimi i Buxhetit 2011/2012*

Nr	Programet Buxhetore	Nr i Stafit 2011	Nr i Stafit 2012	Buxheti total 2011	Buxheti total 2012	Ndryshimi ne euro
1	Zyra e Kryetarit	6	7	64,447	92,300	27,853
2	Zyra e Kuvendit			45,482	51,500	6,018
3	Administrata	17	15	116,662	122,790	6,128
4	Buxhet dhe Financa	8	7	37,777	39,450	1,673
5	Sherbime Publike	8	8	47,149	52,500	5,351
6	Zyra për Komunitete	1	1	3,012	3,892	880
7	Bujqësi, Pylltari	3	4	13,634	24,620	10,986
8	Zhvillim Ekonomik	2	2	9,764	12,602	2,838
9	Planifikim Urban	7	7	420,557	374,577	(45,980)
10	Shëndetësi	32	32	163,171	182,021	18,850
11	Sherbimet Sociale	2	3	15,613	20,171	4,558
12	Arsim dhe Shkencë	125	126	600,370	613,304	12,934
	<b>Gjithsej</b>		<b>1</b>	<b>1,537,638</b>	<b>1,589,727</b>	<b>52,089</b>

Rritja e buxhetit 2012 ne raport me vitin 2011 është 3.39%

Tabela - 9

*Pjesmarrja e kategorive ekonomike ne strukturen e Buxhetit 2012*

Nr	Kategorite Ekonomike	% / buxheti total	Granti i përgjith.	Granti i Arsimit	Granti i Shendet.	HVK 2012
		<b>1,589,727</b>	<b>641,402</b>	<b>613,304</b>	<b>182,021</b>	<b>153,000</b>
1	Paga & Meditje	65.00	48.09	92.26	87.35	-
2	Mallera & Sherbime	9.27	15.65	4.89	9.35	-
3	Shpenzime Komunale	2.01	2.65	1.47	3.30	-
4	Subvencione & Transf	1.89	4.68	-	-	-
5	Shpenzime Kapitale	21.83	28.93	1.38	-	100.00
	<b>Gjithsej</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>

## 2. Strategjia Zhvillimore sipas sektorëve

Në periudhën e deritanishme të pasluftës, në komunën tonë është përgatitur dhe hartuar një (01) draft - Strategji zhvillimore, në të cilat dokumente janë paraqitur caçet dhe prioritet e politikave zhvillimore në sektorët e caktuar, dhe ato të :

- Strategjia për zhvillim social - ekonomik .
- Plani i zhvillimit Komunal
- Plani i zhvillimit Urban.

Të bazuar në këtë strategji zhvillimore dhe kërkesave buxhetore të parashtruara nga programet / drejtoritë, deri më tani janë bërë përpjekjet të vazhdueshme për përfshirjen sa më të mirë të këtyre prioriteve buxhetore për vitet 2011-2013, kurse implementimi i tyre gjithmonë do të bëhet në përputhje me mundësitë tona buxhetore.

Po ashtu, ia vlenë të përmendet se gjatë këtij viti janë duke u perfunduar punimet hartuese nga OJQ - Un-Habitati për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban të Komunës, i cili dokument zhvillimor do të ketë një rol shumë të rëndësishëm në strategjinë tone zhvillimore në shtigjet afatgjate.

Gjatë periudhës kohore, qershor 2011, komuna ka përgatitur Qarkoren Interne Buxhetore nr.2012/01., ku kemi përcaktuar tri (03) prioritet e larta për buxhetimin e komunës për periudhën afatmesëm 2012-2014, si

### Prioriteti -1,

Vazhdimi i aktiviteteve në ndërtimin e infrastrukturës komunale me qëllim të zhvillimit të sektorit publik dhe të sektorëve të tjerë të ekonomisë – si parakusht themelor për nxitjen e zhvillimit socio – ekonomik të komunës;

### Prioriteti -2,

Ngritja e të gjitha kapaciteteve njerëzore dhe materiale për avancimin e shërbimeve në institucionet e sektorit publik, si në administratë, arsim dhe shëndetësi, përmes zbatimit kualitativ të të gjitha reformave nga sektori publik;

### Prioriteti -3,

Identifikimi, rifreskimi dhe përpilimi i Listave të Projekteve Prioritare të nivelit të lartë në sferën e investimeve kapitale nga sektori publik;

Në kontekst të procedurave obligative në nxerrjen e Draft-Buxhetit Afatmesëm të Komunës për periudhën afatmesme 2012-2014, gjatë dëgjimeve të parashikuara publike, do të ofrohet strategjia zhvillimore me prioritet dhe me programet konkrete investive sipas sektorëve të caktuar..

Gjatë fazave të më tejme, e sidomos nga dëgjimet publike të parashikuara në muajt vijues, nga programet / drejtoritë bartëse, do të kompletohet Lista e Projekteve Prioritare sipas sektorëve për çdo vit buxhetor, përfshirë këtu edhe burimet e financimit të këtyre projekteve.

Në vazhdim të Draft – Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës për vitet 2012-2014, në tabelën - 11, pasqyrojmë Listën me 51 projekte, në shumë totale të përafërt prej 1,101,399 €, të cilat do të shqyrtohen dhe renditen sipas prioritetit dhe viteve buxhetore.

**Tabela 10. LISTA E PROJEKTEVE PRIORITARE PËR VITIN 2012-2014**

<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i Projektit</b>	<b>2012 Plani</b>	<b>2013 Vlerësimi</b>	<b>2014 Vlerësimi</b>
	<b>Planifikimi Urban dhe mjedisi</b>			
1	Asfaltimi i rrugës lagja Meliq - Varrezat e Dëshmorëve	10,000		
2	Asfaltimi i rrugës Dheu i Bardhë - Paldenicë	20,000		
3	Mjete të lira për bashkëinvestime	40,000	60,000	60,000
4	Fond për hartimin e projekteve-planeve	10,000	10,000	10,000
5	Ndërtimi i shtratit të lumit Lepenc	21,000		
6	Themelimi i Bibliotekës së Qytetit	20,000		
7	Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjes në Han të Elezit	20,000		
8	Kyçja e kanalizimit të kufirit në rrjetin e qytetit	20,000		
9	Rregullimi i përroit të shtratit të Dimcës	8,000		
10	Rregullimi i rrethjes së Varrezave të Dëshmorëve	10,000		
11	Ndërtimi i një vendqëndrimi të autobusëve në Han të Elezit	4,114		
12	Pyllëzimi i zonave të zhveshura	5,043		
13	Asfaltimi i rrugës të ujësjes në Dimcës	5,500		
14	Kyçja e kanalizimit nga Lagja e Brave në rrjetin e qytetit	16,000		
15	Rregullimi i rrugës Uji I Tharte - Pustenic	21,000		
16	Punimi i ujësjes në fshatin Paldenicë	10,000		
17	Punimi i planeve rregullative Komunale	10,000		
18	Fasadimi i objektit të komunës	14,000		
19	Fasadimi i objekteve publike të Komunës	10,000		
20	Rregullimi i hapësirës dhe rrugës për varrezat e reja	10,000		
21	Kubezimi i rrugicave të fshatit Paldenicë	10,000		
22	Rehabilitimi dhe rregullimi i zyreve në komunë	20,000		
23	Ndërtimi i murit mbrojtës për reduktim të rrezikut nga rrëshqitjet e dheut në lagjen Brava	20,000		
24	Ndërtimi i stacionit të veterinarisë		25,000	
25	Ndërtimi i impiantit për ujëra të zeza		40,000	
26	Salla e kultures fizike të SH.F. "Keshjtellae e Diturise"		20,000	
27	Kubezimi i rrugicave të fshatit Krivenik		10,000	
28	Ndërtimi i çerdhës për fëmijë		50,000	
29	Asfaltimi i rrugës Ramuk - Kashan		25,000	
30	Vendosja e ndriçimit në rrugicën përreth vijës hekurudhore		8,300	
31	Montimi i ulëseve të stadiumit " Suad Brava "		30,000	

32	Asfaltimi i rrugës Uji i Thartë - Pusteni - Lagja e vjetër		22,568	
33	Asfaltimi i rrugës Krivenik - Gorancë		20,000	
34	Asfaltimi i rrugës Gorancë - Globoqicë		20,000	
35	Dekontaminimi i brigjeve përreth lumit Iepenc te kontaminuar nga asbesti		23,110	
36	Ndërtimi i shkollës së re në lagjen e re			100,000
37	Rihapja e rruges Pusteni - Rezhancë - Gorancë			15,000
38	Rihapja e rruges Pusteni - Laq			10,000
39	Rihapja e rrugës Neqavc - Dremjak			10,000
40	Punimi i Kanalizimit i fshatit Laq			10,000
41	Kubezimi i rrugicave te fshatit Laq			5,000
42	Ndriqimi i rruges Lagja e re Seqishtë			10,000
43	Rregullimi i burimit te ujit te tharte dhe prurja me gypa deri ne Han te Elezit			10,000
44	Ndërtimi i nje stacioni te autobuseve			20,000
45	Rregullimi i kanalizimit fekale nga fsh. Gorancë – Rezhancë - Hani i Elezit			20,000
46	Punimi i kanalizimit fekal nga Fsh. Krivenik - Seqishtë			30,000
47	Aneksi i shtëpisë se Kulturës			40,000
48	Ndërtimi i stacionit te autobusëve			17,285
49	Ndërtimi i një stacioni të ambulancës në fshatin Paldenicë			10,000
	<b>Arsimi dhe Shkenca</b>			
50	Aneksi i shkollës fillore "Ilaz Thaçi" ne Han te Elezit - faza e dyte	6,000		
51	Mjete mësimore për kabinete te shkollave	2,473	3,500	2,473
52	Rregullimi i infrastrukturës shkollore		4,973	6,000
	<b>Totali</b>	<b>343,130</b>	<b>372,451</b>	<b>385,758</b>

Drejtor për Buxhet dhe Financa:  
Shabi Rexhallari

\_\_\_\_\_

V.V.

Kryetari i Komunës:  
Rufki Suma

\_\_\_\_\_

## Zyra e Kryetarit

Kryetari: Rufki Suma

**Deklarata e misionit:** Përgatitja e të gjitha materialeve për mbledhjet e kuvendit komunal, në sferën e legjislacionit të nivelit të qeverisjes lokale ( nxjerrja e rregulloreve , vendimeve udhëzimeve etj.) që kanë të bëjnë me një qeverisje sa më të mire të të gjitha drejtorive të komunës dhe gjithnjë në shërbim të gjithë qytetarëve të komunës.

**Deklarata e Vizionit:** Administrata është përgjegjëse për sigurimin e personelit të drejtorisë me udhëzime , politika dhe procedura për menaxhimin dhe implementimin e aktiviteteve , menaxhimin e buxhetit dhe financave të drejtorisë.

**Deklarata e Qëllimit:** Komisioneve të K.K me subjektet relevante në nivelin qendror dhe lokal , OJQ- të dhe biznesin etj, me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe për një zhvillim të qëndrueshëm të Komunës në përgjithësi dhe me këtë edhe ngritjes së mirëqenies për të gjithë qytetarët e komunës sonë.

### Performancë:

Kategoritë buxhetore		2012	2013	2014
1.	Paga dhe mëditje	45,300	45,300	45,300
2.	Mallra dhe shërbime	22,000	22,000	22,000
3.	Transfere dhe subvencione	25,000	25,000	25,000
4.	Kapitale	0	0	0
<b>TOTALI:</b>		<b>92,300</b>	<b>92,300</b>	<b>92,300</b>

Numri i të punësuarve	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>7</b>
-----------------------	----------	----------	----------

	2012	2013	2014
Kuantitative			
Përgatitja e të gjitha materialeve për mbledhjet e Kuvendit komunal, në sferën e legjislacionit të nivelit të qeverisjes lokale ( nxjerrja e rregulloreve , vendimeve , udhëzimeve ) që kanë të bëjnë me një qeverisje sa më të mirë të të gjitha drejtorive të Komunës dhe gjithnjë në shërbim të gjithë qytetarëve të Komunës.	Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike të planit vjetor.	Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike të planit vjetor.	Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike të planit vjetor.

	2012	2013	2014
Kualitative			
1. Kuvendi gjatë gjithë vitit kalendarik planifikon të mbajë 12 mbledhje të rregullta,	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>12</b>
2. KPF poashtu 12 mbledhje obligative,	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>12</b>
3. Mbledhjet e rregullta me drejtorët e drejtorive.	<b>48</b>	<b>48</b>	<b>48</b>

## Deklarata për misionin dhe performansën e Drejtorisë së Administratës

### Drejtori i Administratës : Fari Kalisi

**Deklarata e misionit:** Ndërtimi i një Administrate profesionale , efikase dhe transparente në shërbim të të gjithë qytetarëve , ofrimi i shërbimeve të shpejta dhe kualitative për qytetarët e komunës së Hnait të Elezit . Zbaton të gjitha aktet dhe vendimet e Komunës , përgatit raportin e punës dhe progrmin , objektivat e kësaj drejtorie .  
Kryen edhe punë të tjera që ngarkohet nga Kryetari .

**Deklarata e Vizionit:** Administrat siguron të gjitha shërbimet administrative për Kryetarin dhe Kuvendin , procedurat e menaxhimit të stafit të shërbimit civil , gjithashtu menaxhon me stafin dhe buxhetin e kësaj drejtorie .

**Deklarata e Qëllimit:** Menaxhimi dhe ngritja e nivelit të lartë në administratën Komunale , si dhe ngritja e kapaciteteve dhe shërbimeve më cilësore për qytetarët .

### Performansë:

Kategoritë buxhetore	2012	2013	2014
1. Paga dhe mëditje	60,790	60,790	60,790
2. Mallra dhe shërbime	45.000	45.000	45.000
3. Shpenzime komunale	17.000	17.000	17.000
4. Transfere dhe subvencione	0	0	0
5. Kapitale	0	0	0
<b>TOTALI:</b>	<b>122.790</b>	<b>122.790</b>	<b>122.790</b>

Numri i të punësuarve	15	15	15
-----------------------	----	----	----

	2012	2013	2014
<b>Kuantitative</b>			
1 .Do të lëshohen certifikata të gjendjes civile	Gjatë gjithë kohës	Gjatë gjithë kohës	Gjatë gjithë kohës
2.Pranimi i kërkesave , ankesave dhe parashtresave	Gjatë gjithë kohës	Gjatë gjithë kohës	Gjatë gjithë kohës
<b>Kualitative</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>
1. puna reth certifikimit do të bëhet sipas programit unik të Kosovës , ku do te kemi një përmisim të kualitetit në shërbimet e karakterit civil.	100%	100%	100%

## Drejtoria për Buxhet dhe Financa

**Drejtori: Shabi Rexhallari**

**Deklarata e misionit:** Bënë menaxhimin e buxhetit dhe financave të komunës, i siguron drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhimin e shpenzimeve dhe informon drejtorët komunal me aktualitetet e ndërlidhura me buxhetin e komunës.

**Deklarata e Vizionit:** Përgatitja e materialeve për KPF, menaxhimin financave komunale, përgatitjen e prezantimit të buxhetit, koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të drejtorisë, këshillon zyrtarët komunal për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin dhe financat.

**Deklarata e Qëllimit:** Menaxhimi më eficient i buxhetit komunal, përgatit buxhetin komunal për të gjitha organizatat buxhetore brenda afateve kohore të përcaktuara nga MF-ja, rishikimet buxhetore, analizat, raportet etj.

### Performancë:

Kategoritë buxhetore		2012	2013	2014
1.	Paga dhe mëditje	35,750	35,750	35,750
2.	Mallra dhe shërbime	3,700	3,700	3,700
3.	Transfere dhe subvencione	0	0	0
4.	Kapitale	0	0	0
<b>TOTALI:</b>		39,450	39,450	39,450

Numri i të punësuarve	7	7	7
-----------------------	---	---	---

	2012	2013	2014
Kuantitative			
1. Do të përgatiten raportet buxhetore -financiare mujore	12	12	12
2. Do të shpërndahen faturat mbi ngarkesën e tatimit ne prone, identifikimin e pronave të reja që do të ndikojnë në rritje e numrit të fakturave.	2,124	2,130	2,135
3. Përpilimi dhe aprovimi i buxhetit vjetor dhe rishikimi për organizatat buxhetore.			

	2012	2013	2014
Kualitative			
1. Të hyrat e realizuara nga tatimi në pronë do të shpenzohen në realizimin e projekteve kapitale.	100%	100%	100%
2. Menaxhimi me eficient i buxhetit dhe ekzekutimi i tij në mënyrë kualitative dhe sipas dinamikës së planifikuar të rrjedhjes së parasë së gatshme.			

## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

Drejtori : Rufat Shkreta

**Deklarata e misionit:** menaxhon, organizon dhe administron me sektorët dhe shërbimet ne kuadër te saj sipas kuadër te saj sipas instruksioneve administrative e te direktivave operative për çfarëdo çështje qe ka te beje me funksionet dhe përgjegjësitë e DSHPE-së.

**Deklarata e Vizionit:** realizimi i suksesshëm i planit për parandalimin e emergjencave, reagimin e shpjët dhe te sukseshem ndaj emergjencave, intervenimie te sukseshme te shërbimit te zjarrfikësve dhe shpëtimit, rritjen e performansës ne shërbimin e zjarrfikësve dhe shpëtimit, mirëmbajtja e pastërtisë se qytetit, ndriçimi elektrik i qytetit dhe i ter zonës urbane, si dhe menaxhimin rrjetit te ujësjellësit , kanalizimit dhe mbeturinave.

**Deklarata e Qëllimit:** Menaxhim dhe organizimi i situatave te fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, menaxhimi i mbeturinave dhe ujë te pijshëm.

### Performansë:

Kategoritë buxhetore	2012	2013	2014
1. Paga dhe mëditje	40,290	40,290	40,290
2. Mallra dhe shërbime	12,210		
3. Transfere dhe subvencione	0	0	0
4. Kapitale	0	0	0
<b>TOTALI:</b>	<b>52,500</b>	52,500	52,500

Numri i të punësuarve	8	8	8
-----------------------	---	---	---

	2012	2013	2014
<b>Kuantitative</b>			
1. Përgatitja e raportit vjetor të DSHPE-së dhe emergjencës.	12	12	12
2. Do të alarmohen qytetaret për shkallen rrezikshmërisë ne raste fatkeqësie.			
<b>Kualitative</b>			
1. shërbime të drejta ndaj qytetareve.	100%	100%	100%
2. Menaxhimi i ujësjellësve sipas dinamikës së planifikuar.			

## Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**Deklarata e misionit:** Siguron zbatimin e ligjeve dhe vendimeve të tjera të aplikueshme, bën përgatitjen dhe hartimin e akteve të përgjithshme normative të drejtorisë, Përgatitë Planin Strategjik të Zhvillimit të Bujqësisë, koordinon dhe kontrollon të gjitha sferat që kanë të bëjnë me bujqësi.

**Deklarata e Vizionit:** Përgatit dhe harton : Propozim Vendime,aktvendime,konkluzat,urdhëresa, procesverbale, kontrata, vërtetime, lajmërimet dhe shkresa të tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë e drejtorisë.

**Deklarata e Qëllimit:** Menaxhimi dhe zbatimi më efikas i politikave bujqësore si dhe mbrojtja e prodhuesëve vendor.mbikqyrja e pyjeve dhe zbatimi masave disiplinore kundër prerësve ilegal të pyllit.

### Performansë:

Kategoritë buxhetore		2012	2013	2014
1.	Paga dhe mëditje	17,120	17,120	17,120
2.	Mallra dhe shërbime	2,500	2,500	2,500
3.	Transfere dhe subvencione	5,000	5,000	5,000
4.	Kapitale			
<b>TOTALI:</b>		<b>24,620</b>	<b>24,620</b>	<b>24,620</b>

Numri i të punësuarve	4	4	4
-----------------------	---	---	---

	2012	2013	2014
Kuantitative			
1.Ruajtja e tokave bujqësore, 2.Ruajtja e pyjeve publike, 3.Kërkesa për ndërrim destinimi të tokave, 4.Kërkesa për prerjen e pyjeve private 5.Kërkesa për subvencione			
Kualitative			
1.Kërkesa për ndërrim destinimi të tokave, 2.Kërkesa për prerjen e pyjeve private 3.Kërkesa për subvencione	<b>40</b> <b>70</b> <b>100</b>	<b>50</b> <b>80</b> <b>120</b>	<b>60</b> <b>100</b> <b>120</b>

**Drejtori i BPZHR**  
**BESNIK REÇI**

## Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

Drejtori: Xhevdet Shkreta

**Deklarata e misionit:** Krijimi i sektorit për planifikim dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;

**Deklarata e Vizionit:** Caktimi i prioriteteve për investim në komunë dhe mbajtja e evidencave statistikore për zhvillim ekonomik;

**Deklarata e Qëllimit:** Dhënia e informatave profesionale dhe raporteve për Drejtorinë dhe institucionet e Komunës;

### Performancë:

Kategoritë buxhetore		2012	2013	2014
1.	Paga dhe mëditje	11102	11102	11102
2.	Mallra dhe shërbime	1500	1500	1500
3.	Transfere dhe subvencione	0	0	0
4.	Kapitale	0	0	0
<b>TOTALI:</b>		12602	12602	12602

Numri i të punësuarve	2	2	2
-----------------------	---	---	---

	2012	2013	2014
Kuantitative			
Caktimi i prioriteteve; Mbajtja e evidencave; Hartimi i programeve; Bashkëpunimi; Dhënia e këshillave; Bashkëpunimi me Ministritë; Bashkëveprimi me ndërkombëtarët; Dhënia e informatave profesionale; Koordinimi i punëve me OJQ; ruajtjen e tokave bujqësore; Kryen punë tjera nga lëmia e zhvillimit ekonomik.	11	11	11

	2012	2013	2014
Kualitative			
Strategjia e zhvillimit socialo-ekonomik në bashkërenditje me planin zhvillimor komunal dhe planin zhvillimor urban.	100%	100%	100%

## DREJTORIA PËR URBANIZEM KADASTER DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

**Deklarata e misionit:** Shqyrtimi I të gjitha kërkesave të aplikuesve dhe zgjidhja e tyre konformë ligjeve në fuqi.

**Deklarata e Vizionit: Hartimi I planeve rregulluese dhe rregulloreve për gjithë teritorin e Komunës**

**Deklarata e Qëllimit: Përmes implementimit të planeve rregulluese të ndërtojmë Komunën si dhe të risim të hyrat buxhetore Komunale.**

### Performansë:

Kategoritë buxhetore		2012	2013	2014
1.	Paga dhe mëditje	34,920	34,920	34,920
2.	Mallra dhe shërbime	5,000	5,000	5,000
3.	Transfere dhe subvencione	0	0	0
4.	Kapitale	334,657	355,505	368,812
	<b>TOTALI:</b>	<b>374,577</b>	<b>395,425</b>	<b>408,732</b>

Numri i të punësuarve	7	7	7
-----------------------	---	---	---

	2012	2013	2014
Kuantitative			
1. Trajtimi i kërkesave urbanistike	450	500	600
2. Trajtimi i kërkesave të kadastrit	600	700	800
Kualitative			
1. Trajtimi i kërkesave urbanistike	400	450	550
2. Trajtimi i kërkesave të kadastrit	500	650	750

Data :02.06.2011

Drejtori i DUKMM  
Miqail Vila

## DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

**Deklarata e misionit:** DSHMS siguron zbatimin e kujdesit parësor shëndetësor duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese, nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjeksësisë primare, si dhe brenda synimeve të politikave shëndetësore të siguroj ofrimin e shërbimeve shëndetësore kualitative, mbikqyrë situatën epidomologjike në nivel komunal, si dhe përkujdesjen për mirëqenie sociale të kategorive të caktuara të popullatës së saj.

**Deklarata e Vizionit:** KPSH kujdeset për informimin shëndetësor, kujdesein esencial kurativ, dhe emergjent gjatë 24 orëve, shëndetin oral, shëndetin mendor, furnizimin me barna, kujdesin antenatal, kujdein posnatal, planifikimin familjar, kujdesin paliativ e tj.

**Deklarata e Qëllimit:** Arritja e rezultateve sa më të mira e më të larta në sferën e shëndetësisë primare.

### Performansë:

Kategoritë buxhetore	2012	2013	2014
1. Paga dhe mëditje	172,171	172,171	172,171
2. Mallra dhe shërbime	24,021	24,021	24,021
3. Shërbime komunale	6,000	6,000	6,000
4. Transfere dhe subvencione	0	0	0
5. Kapitale	0	0	0
<b>TOTALI:</b>	<b>202,192</b>	<b>202,192</b>	<b>202,192</b>

<b>Numri i të punësuarve</b>	<b>35</b>	<b>35</b>	<b>35</b>
------------------------------	-----------	-----------	-----------

	2012	2013	2014
<b>Kuantitative</b>			
1. Edukim shendetesor 2. Vaksinin 3. Diagnostifikim i sëmundjeve 4. Trajtim i sëmundjeve 5. Kujdesi paliativ 6. Sistemi informativ shëndetësor (SISH) 7. Infrastruktura (objekti)	Tërë vitin	Tërë vitin	Tërë vitin
<b>Kualitative</b>			
1. Planifikimi 2. SWOT Analiza- Analiza kerkimore 3. Auditi shëndetësor 4. Hulumtimet	Niveli i kualitetit mvaret nga pergaditja profesioanle e stafit	Niveli i kualitetit mvaret nga pergaditja profesioanle e stafit	Niveli i kualitetit mvaret nga pergaditja profesioanle e stafit

Data : 02.06.2011

**Drejtori i DSHMS-së  
SAFET BUSHI**

## Drejtoria për Arsim , Kulturë, Rini e Sport

Drejtori Nazim Laçi

**Deklarata e misionit:** DKA-Ushtron funksionet dhe pergjegjesit e saj ne baze te ligjit lidhur me organizimin e Arsimit per nxënës .Nxit barazin me mundesin per te ndjekur arsimin ne te gjitha nivelet e komunene zhvillimin dhe aftësimin e personelit per mesim sa me cilësor.

**Deklarata e Vizionit:** Pos mundesise per ndjekjen e arsimit ,nxit edhe bashkëpunimin midis mesimdhenesve ,prindërve,nxenesve dhe instuticioneve arsimore

**Deklarata e Qëllimit:** Arritja e standartevesa më të larta ne sferen e Arsimit

### Performansë:

Kategoritë buxhetore		2012	2013	2014
1.	Paga dhe mëditje	565,831	565,831	565,831
2.	Mallra dhe shërbime	30,000	30,000	30,000
	Shërbime komunale	9,000	9,000	9,000
3.	Transfere dhe subvencione	0	0	0
4.	Kapitale	8,473	8,473	8,473
	<b>TOTALI:</b>	<b>613,304</b>	<b>613,304</b>	<b>613,304</b>

Numri i të punësuarve	126	126	126
-----------------------	-----	-----	-----

	2012	2013	2014
Kuantitative			
1 Kalendari i MASHT-it të zbatohet me përpikëri			
Kualitative			
1. Të siguroj kushte optimale që procesi edukativo arsimor dhe kultura te ngritët ne nivelin me te larte te zhvillimit	100%	100%	100%